



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

Departamenti:	Shërbimet e Përgjithëshme
Titulli:	Zyrtar për Përkthime
Nr. Ref:	RN00005486
Kategoria Funktionale:	Niveli i koeficientëve
Koeficienti:	7 (shtatë)
Lloji i Pozitës:	i Karrierës
Orët e Punës:	40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit:	Nëpunës i karrierës
Vendi i punës:	Rr. Ahmet Krasniqi 210 (selia e Zyrës Kombëtare të Auditimit)
Qëllimi i vendit të punës:	Lehtësimi i komunikimit efektiv për zyrtarët e ZKA-së përmes shkresave, dokumenteve dhe në të folur si dhe përkthimi dokumenteve të ndryshme të ZKA-së dhe dokumenteve që i adresohen Zyrës Kombëtare të Auditimit
I përgjigjet:	Udhëheqësit të Divizionit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime për realizimin e këtyre objektivave; 10%
2. Ofron përkthime dhe interpretime gjuhësore për stafin e ZKA-së gjatë takimeve të ndryshme, intervistave, konferencave, etj.; 20%
3. Përkthen shkresat, dokumentet e ndryshme të ZKA-së dhe shkresat, dokumenteve që i adresohen ZKA-së; 15%
4. Bën përkthimin me shkrim të materialeve dhe dokumenteve si: rregulloret, ligjet, broshurat, raportet e mediave, komunikatat për shtyp, etj.; 15%
5. Bën përkthim/interpretimin simulant në takimet zyrtare, konferenca, seminare e të ngjashme; 15%
6. Ndhmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim, gramatikës dhe sintaksës; 10%
7. Mban bazën e të dhënave të informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të të gjitha dokumenteve; 10%
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet, 10%.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma universitare në drejtimet shoqërorë, 2 vite përvojë pune
- Njohuri dhe përvojë në fushën përkthimeve të gjuhës angleze dhe anasjelltas
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Zyra Kombëtare e Auditimit/ Rr. Ahmet Krasniqi 210 Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore, tel: 038/606-004/1004 ose 038/606-004/1005, prej orës 08:00 – 16:00. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe tabelën e shpalljeve në gazetatat ditore

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.” “Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.